



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 610/6 prot.

Tiranë, më 24.4.2026

V E N D I M

Nr. 16, datë 24.04. 2026

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 25, DATË 23.10.2017, “PËR NORMIMIN DHE SHPËRBLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE, NË ZBATIM TË PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR DHE VAZHDUES, NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS”

Mbështetur në nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 243 dhe 248 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”; në nenin 124 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; si dhe të ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 11.6.2009, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, (i ndryshuar), me propozim të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues, i mbledhur më datë 24.4.2026

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 25, datë 23.10.2017, “Për normimin dhe shpërblimin e veprimtarisë akademike, në zbatim të programit të formimit fillestar dhe vazhdues, në Shkollën e Magjistraturës”, bëhen këto shtesa:

1. Shtohet shtohet pika 18/1 me këtë përmbajtje:

“18/1. Koordinatorët e moduleve do të shpërblehen për 10 orë përgatitore për hartimin kurrikulës së modulit (jo më pak se 3 tema për modul) dhe 3 orë për koordinimin dhe hartimin e raporteve përfundimtare për secilin temë të realizimit të modulit”.

2. Në lidhjen nr.1 “Konvertimi i elementëve për përgatitjen dhe mbështetjen e procesit të formimit profesional në kuadrin e Formimit Fillestar dhe Vazhdues, pika III “Formimi Vazhdues”, shtohen pikat 4 dhe 5 si më poshtë:

III.	Formimi Vazhdues (neni 272, ligji 115/2016, Rregullorja e Brendshme)	
1.	<i>Përgatitja e moduleve (jo me pak se 3 tema per modul)</i>	<i>10 orë mësimore/ modul</i>
2.	<i>Koordinimi dhe hartimi i raporteve përfundimtare për trajnimet</i>	<i>3 orë mësimore/teme</i>